

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”

**Fakulteti i Filologjisë
Dega Letërsi shqipe**



Lidhja e Prizrenit në letërsinë popullore

Punim diplome

Komisioni:

Kryetar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

Mentori:
Prof.Ass.Dr.Besim Muhadri

Kandidati:
Fitore Perteshoni Mullahasani

Gjakovë, 2018

Përmbajtja

- Objekti i hulumtimit-----	2
- Qëllimi i hulumtimit-----	2
- Detyrat e hulumtimit-----	2
- Hipoteza e hulumtimit-----	3
- Metodatat e hulumtimit-----	3
- Hyrje -----	4
- Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe formimi i saj-----	5
- Lidhja e Prizrenit në letërsinë popullore -----	11
- Epika historike kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit -----	22
- Përfundim -----	29
- Literatura -----	31

Objekti i hulumtimit

Duke e marrë për bazë se ekzistojnë një numër i madh i metodave dhe teknikave të cilat përdoren në shkencën bashkëkohore. Kemi marr për objekt të studimit rolin e këtyre metodologjive në zhvillimin e njohurive rreth letërsisë popullore gjatë periudhës së Lidhjes së Prizrenit. Për të studiuar këtë problem shkenca ka interes, shoqëria dobi të shumëfishë. Sepse ky problem shkencor sidomos pas luftës është hulumtuar në disa aspekte teorike dhe në aspektet praktike deri më sot në vendin tonë.

Studimi i rolit të të letërsisë popullore gjatë Lidhjes së Prizrenit në këtë punim modest ka për qëllim të jap një pasqyrë shkencore të deritashme në fushën e zhvillimit të kësaj fushe.

Qëllimi i hulumtimit

Të shqyrtoi dhe analizoi rolin dhe rëndësinë e e letërsisë popullore në ngritjen e vetëdijes kombëtare;

Të jap një pasqyrë shkencore të deritashme në fushën zhvillimit të rolit të letërsisë popullore të periudhës së Lidhjes së Prizrenit.

Të identifikojë tiparet kryesore në zhvillimin emocional, psikik dhe komunikues të letërsisë popullore të kësaj periudhe tek shqiptarët.

Detyrat e hulumtimit

Cili është roli i përdorimit të letërsisë popullore të periudhës së Lidhjes së Prizrenit, në zhvillimin e vetëdijes kombëtare;

Të mbledh fakte për të ndryshme nga literatura mbi ndikimin e letërsisë popullore të periudhës së Lidhjes së Prizrenit në zhvillimin intelektual, social, emocional të popullit shqiptar.

Hipoteza e hulumtimit

Ne mendojmë se në punimin e “Letërsisë popullore të periudhës së Lidhjes së Prizrenit”, do të vërtetohet se letërsia popullore ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e vetëdijes kombëtare.

Metodat e hulumtimit

Hulumtimi i literaturës përkatëse

Mbledhja e të dhënave për rolin e Letërsisë popullore të periudhës së Lidhjes së Prizrenit në ngritjen e vetëdijes kombëtare.

Hyrje

Duke pasur parasysh rrethanat historiko-politike të shqiptarëve si dhe popujve të tjerë të Ballkanit, lind ideja e pashmangshmërisë së ndikimit të faktorit politik e shoqëror si faktor shumë i rëndësishëm jashtëtekstor në veprat letrare artistike të shkrimtarëve që krijuan para shpalljes së Pavarësisë, si dhe atyre të cilët i krijuan veprat e tyre pas shpalljes së Pavarësisë.

Titulli “Letërsia e Rilindjes Kombëtare Frymëzuese e Pavarësisë” bart në vete logjikën dhe filozofinë e triumfit të lirisë mbi robërinë në kuptimin moral, kombëtar, esencial dhe ekzistencial, censurën e kufizimit të lirisë në kuptimin elementar, kufizimit të mendimit, veprimet dhe shprehjes së lirë.

Duke hedhur një vështrim mbi krijimtarinë e shkrimtarëve shqiptarë para viteve të pavarësisë, do të shohim ndryshimin e ideve, mënyrën e shkrimit, stilin, përzgjedhjen e temave, mënyrën e portretizimit dhe profilizimit të personazheve, format e narracionit, trajtimi i problemeve të mprehta shoqërore të kohës, që paraqiten me një gjuhë të fshehur dhe të tërthortë. Edukimi i brezit intelektual dhe popullit në përgjithësi me anë të veprave artistike, traktateve filozofike dhe ideve e fenomeneve, të tjera janë shkolla e vetme që e karakterizojnë këtë periudhë.

Për ta hulumtuar krijimtarinë letrare para periudhës së shpalljes së pavarësisë, paraqitet nevoja e pashmangshme e një krahasimi të saj me krijimtarinë pas kësaj periudhe. Një studim i këtillë krahasues do t’i nxirrte në pah vlerat, përparësitë, veçoritë, ndryshimet dhe ndikimet mes veprave të këtyre periudhave.

Në këtë studim janë përfshirë disa nga elementet kyçe të krijimtarisë së rilindësve, të pasqyruara përmes gjuhës së pasur figurative, stilit, përzgjedhjes së temave, sidomos patriotizmi si impuls gjithëpërfshirës krijues, miti pellazgjik i prejardhjes së shqiptarëve, elementi folklorik në veprat e tyre, etosi, empatia, kulti i ardhmërisë së popullit, në veprat e disa shkrimtarëve të Rilindjes kombëtare, proza romantike, proza epistolare etj.

Studimi im fokusohet mbi format e narracionit, portretizimin e personazheve, risitë e stilit, tradita e shkrimit, novatorizmi, konceptet ideo-estetike, laramania e trajtave të shkrimit, tipologjia e personazheve, format kompozicionale, mikro dhe makro struktura e ndërtimit të veprave, veçoritë, ndikimet, përkimet si dhe ndikimi i rrethanave tekstore dhe jashtë tekstore në ndërtimin e veprave të analizuara në vija të përgjithshme.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe formimi i saj

Në kushtet e Krizës Lindore, një element i rëndësishëm i së cilës ishte edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare, u shënuar një kthesë e rëndësishme në zhvillimin e saj, u krijua organizata mbarëshqiptare – Lidhja e Prizrenit. Lidhja dhe udhëheqësit e saj përpunuan programin më të plotë politik të lëvizjes kombëtare për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë që kërcënohej nga monarkitë fqinje, për bashkimin e të gjitha trevave shqiptare në një shtet autonom kombëtar. Në këtë fazë, nën drejtimin e Lidhjes së Prizrenit dhe të udhëheqësve të saj më të vendosur, u bë përpjekja e parë për të sendërtuar me rrugën e luftës së armatosur programin e lëvizjes kombëtare, për të themeluar shtetin kombëtar shqiptar. Nga kjo fazë çështja shqiptare u bë një realitet objektiv në politikën ballkanike të Fuqive të Mëdha, një element i pandarë i kombinacioneve të tyre diplomatike në Ballkan dhe në Evropë.

Në rrethanat ndërkombëtare të kohës kur Kriza Lindore do të arrijë kulmin me luftën Ruso-Osmane 1877-1878, padyshim që dy ngjarje ndërkombëtare luajtën rolin e tyre në thellimin e Krizës: Protokollin e Londrës dhe Konferencën e Stambollit (Dhjetor 1876), e cila kishte caktuar edhe vijat kufitare të dy provincave Bullgare ku në kuadër të saj u përfshin krahina dhe qendra me popullsi shqiptare si Kaçaniku, Tetova, Gostivari, Dibra etj.¹

Konferenca e Stambollit kishte për qëllim që edhe në veri në kufi me Malin e Zi të bënte lëshime territoriale në dëm të kombit shqiptar.

Mu këto hapa të parë të Konferencës së Stambollit i dhanë sinjal shqiptarëve se tash në një farë mënyre kishte filluar ndarja e zotërimeve osmane midis kombeve të ndryshme të Ballkanit dhe se ata ishin të rrezikuar nga një iniciativë e tillë. Në këto rrethana disa prijës më largëpamës të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Konferencën e Stambollit e panë si shansë që disa vendime të saj mund të shfrytëzoheshin edhe për shqiptarët për të kërkuar autonomi.

Për këtë qëllim në Janinë në pranverë 1877 u thirrë një mbledhje e parisë së Shqipërisë së Jugut në krye me Abdyl Frashërin, për të diskutuar për zhvillimet e reja me të cilat

¹ Aleks Buda, Shkrime Historike, Akademia e Shkencës e Shqipërisë, Tiranë 1986, f. 107.

ndodheshin shqiptarët ku në rend të parë dhe për herë të parë u kërkua autonomia territoriale dhe administrative për Shqipërinë.²

Perandoria Osmane në këtë luftë pësoi disfatë të rëndë dhe vetem kërcënimi i Anglisë me një luftë të re ndaj Rusisë e shpëtoi Perandorinë Osmane nga një shkatërrim i plotë. Palët ndërluftuese nënshkruan traktatin e Shën Stefanit me 3.III.1878, ky traktat pos tjerash parashihte dhënien e pavarësisë për Serbinë, Malit e Zi dhe Rumaninë. Ndërsa sa i përket Bullgarisë ajo fitonte autonominë duke mbetur nën sovranitetin e Sulltanit. Ndërsa sa i përket Shqipërisë, kjo paqe dhe traktat jo vetëm e la atë nën sundimin osman, por edhe e copëtonte mjaftë rëndë duke iu dhënë toka tipike shqiptare Serbisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë, kjo politikë e pansllavizmit Rusë kishte për qëllim zgjerimin e shteteve ballkanike ortodokse sllave në dëm të tokave shqiptare dhe rritjen e ndikimit rusë në këto vise përmes aleatëve të vetë.³

Rreziku i copëtimit të Perandorisë Osmane dhe njëherit duke parë rritjen e ndikimit pansllavist rus në Ballkan ndikuan tek disa shtete Evropiane të kohës e sidomos tek Anglia dhe Austro-Hungaria që paqja e Shën Stefanit të rishikohet nga Fuqitë e Mëdha ku do të pajtohet edhe Rusia. Fuqitë e Mëdha vendosën që të mblidhen për këto qëllime në Kongresin e Berlinit, i cili do t'i filloi punimet e veta më 13 qershor 1878.⁴

Vendimet e Shën Stefanit shkaktuan në tërë Shqipërinë një valë të re protestash. Filluan mbledhje të shumta anë e mbanë qyteteve të Shqipërisë në mënyrë që të organizoheshin forcat e armatosura për të kundërshtuar copëtimin e çdo toke shqiptare mirëpo situata diktonte që çdo rezistencë të bëhej në formë të organizuar si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, për një organizim të mirëfilltë ishte sidomos Komiteti i Stambollit, i cili kishte qëllim të organizonte një qendër drejtuese kombëtare.⁵

Si vend për tu mbledhur në një Kuvend kombëtar u caktua Prizreni, pikërisht se tokat verilindore ishin më tepër të rrezikuara prej armiqëve dhe një kuvend pikërisht në Prizren do të kishte efekt më të madh. U vendos që kuvendi të filloi punimet me 10 Qershor 1878, pak ditë para hapjes së Kongresit të Berlinit dhe pikërisht në këtë ditë i filloi punimet dhe u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si organizatë e parë me karakter

² Historia e Popullit Shqiptar II, vep.cit, f.140.

³ Mehdi Frashëri, Lidhja e Prizrenit, Tiranë 1938, Kristo Luarasi, f.18.

⁴ Jusuf Buxhovi, Kongresi i Berlinit 1878, Faik Konica, Prishtinë 2008, f.18.

⁵ Po aty., f.152.

kombëtar e cila do të vihej në mbrojtje të interesave jetike të kombit shqiptar nga rreziqet e cekura më lartë.⁶

Mbledhja u mbajt në sallën e medresesë ku fjalën hyërse e mbajti Abdyl Frashëri, ku pos tjerash tha “Qëllimi i kuvendit është që t’ua presim hovin armiqëve të pashpirtë, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që ti mbrojmë me gjakë trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjysherit tanë”.

Mbledhja themeluese e Lidhjes vendosi krijimin e një organizate me karakter politik dhe ushtarak nga një qendër drejtuese dhe me degë të shtrirura në tërë territorin etnik shqiptar. Kështu pra u formua Lidhja Shqiptare ose siç është më tepër e popullarizuar si Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Si organ më i lartë ishte caktuar Kshilli Qendëror, kryetar i të cilit u zgjodhë Iliaz Pashë Dibra, ndërsa anëtarë të Komitetit drejtuesë Ali Pashë Guçia, Shejh Mustaf Tetova, Osman Efendiu etj.⁷

Të gjitha vendimet që u morrën në mbledhjen themeluese të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u përfshinë në Kararnamen (libri i vendimeve) që u aprovua me 18 Qershor 1878, në të përfshihen vendimet dhe detyrat e degëve të Lidhjes që të siguronin reparte ushtarake në mënyrë që të vendoset qetësia dhe rendi në vend.

Njëkohësisht u shpallë “Besë” që ndalonte të gjitha “gjaqet”, të gjitha vendimet e aprovuar në lidhje pasqyronin interesat e përbashkta të tërë kombit shqiptar, sidomos për të ruajtur tërësinë territoriale të atdheut për të ruajtur sovranitetin e Sulltanit mbi Shqipërinë si garancion për ruajtjen e vendit nga copëtimi me një autonomi, e cila më vonë me pjekjen e kushteve do të avancohej me pavarësi të plotë, kërkesa për autonomi vinin nga rrethet më të përparuara patriotike shqiptare para Kongresit të Berlinit për t’ia arritur këtij qëllimi. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte e përgatitur edhe politikisht edhe ushtarakisht. Kongresi i Berlinit u hap më 13 Qershor 1878, në të morën pjesë gjashtë fuqitë e mëdha të kohës ku pos tjerash u morën këto vendime: Bullgarisë iu njohë autonomia nën sovranitetin e Sulltanit, Serbia dhe Mali i Zi u bënë shtete të pavarura dhe u zgjeruan territorialisht në dëm të tokave shqiptare, gjithashtu përfitime territoriale mori edhe Greqia e cila mori shumë toka shqiptare.⁸

⁶ Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Toena, Tiranë 1997, f.86;

⁷ Po aty.

⁸ Kristo Frashëri, vep.cit. f.121.

Tani pasi ishte bërë ratifikimi i traktatit të Berlinit, nga ana e Fuqive të Mëdha qeveria Osmane ishte e obliguar të fillonte bisedimet me Malin e Zi, Serbinë dhe Greqinë rreth vendosjes së vijave të reja kufitare, në një situatë të tillë të rëndë për kombin shqiptar Lidhja e Prizrenit nëpërmjet memorandumeve të shumta, protestave dhe tubimeve të ndryshme në të gjitha krahinat e vendit, i sinjalizoi Fuqitë e Mëdha, se do të kundërshtoi me armë copëtimin e tokave shqiptare.

Nga ana tjetër Porta e Lartë kishte bërë përgatitjet e duhura për të vënë në zbatim vendimet e Kongresit të Berlinit, bile ajo kishte dërguar një Gjeneral të vetin ushtarak me emrin Mehemet Ali Pashë Maxharri, i cili për këtë qëllim duhej të shkonte në Kosovë ti bind shqiptarët për mos rezistencë kundër Serbisë dhe Malit të Zi, kundër Fuqive të Mëdha dhe Portës së Lartë dhe vetë interesave të shqiptarëve, siç u shpreh ajo.⁹

Vetë emërimi i një ushtaraku të lartë osman në krye të detyrës për të biseduar me shqiptarët tregon qëllimet e Portës së Lartë, se në qoftë se shqiptarët nuk binden me diplomaci atëherë ai duhej të ndërmerre masa ushtarake për të penguar çdo kundërshtim në realizimin e misionit të tij. Marshalli osman me prejardhje gjermane i shoqëruar nga një agjuntant personal i Sulltanit, i cili kishte qenë i dërguar i Perandorisë Osmane në Kongresin e Berlinit mbërriti në misionin e tij në Kosovë më 25 Gusht të viti 1878, dhe menjëherë thirri drejtuesit e Komitetit të Lidhjes në qytetin e Prizrenit, duke iu bërë presion të pranorin vendimet e Kongresit të Berlinit, por përpjekjet e tij qenë të kota se krerët më radikal ishin kategorik në qëndrimet e veta. Në një situatë të tillë deri sa Marshalli qëndronte në Prizren situata ishte tejet e acaruar dhe Ali Pash Maxharri duke e ndjerë veten të rrezikuar kërkoi përforcime nga Mitrovica. Ai kishte ndërmend të vazhdonte rrugën drejtë Gjakovës si qytet me ndikim të madh të Lidhjes në mënyrë që të bindte krerët për misionin e tij, më 31 gusht 1878, u largua nga Prizreni dhe mori rrugën drejt Gjakovës. Mirëpo, këtu hasi në rezistencë edhe më të rreptë se në Prizren ku disa anëtarë të Lidhjes së Prizrenit dega në Gjakovë si Sulejman Vokshi, Ahmet Korenica, Hasan Agë Batusha etj, mbajtën një qëndrim të pa përkulur ndaj Portës së Lartë.¹⁰

Situata u acarua edhe më tepër kur më 2 shtator një delegacion i Lidhjes u paraqit tek Pashai osman, në konaqet e kullave të Abdulla Pashë Drenit, ku kishte gjetë mikëpritje

⁹ Skender Rizaj, vep e cit, f.87.

¹⁰ Kristo Frashëri, vep e cit, f.146.

ata e ftojnë atë që të largohet nga qyteti. Mirëpo, një kërkesë e tillë u refuzu. Krerëve ushtarak dhe politik të Lidhjes së Prizrenit, dega në Gjakovë nuk u mbeti gjë tjetër vetëm të fillojnë luftën për vrasjen e tij, duke lëshuar kushtimin për luftë. Ushtria e Lidhjes e filloi luftën dhe për tre ditë sa zgjati ajo ia arriti të vrasë Marshallin Osman dhe gjithë shoqëruesit e tij dhe mikëpritësit. Mirëpo edhe nga ana e lidhjes pati mjaftë viktima.¹¹

Ngjarjet e Gjakovës patën jehonë të madhe si në vend ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Në brendi të vendit ato sollën një shthurje të plotë të administratës Osmane në këto vise, ndërsa jehona ndërkombëtare tregonte vendosmërin e shqiptarëve se më parë do të pranonin të vdisnin se sa të copëtohet atdheu i tyre.

E vendosur që të zbatonte vendimet e Kongresit të Berlinit, Porta e Lartë dërgoi në tokat shqiptare Marshallin e vet Muhar Pasha, që me forca të shumta ushtarake ta shuante rezistencën shqiptare. Ai u dha urdhër forcave Osmane që të tërhiqen nga Plava dhe Gucia, por shqiptarët e kërcënuan atë me luftë duke bërë rezistencë. Rezistenca shqiptare i shtyri Fuqitë e Mëdha ta rishikoninë çështjen.¹²

Nga frika se se do të përsëritej ngjarja e Gjakovës Marshalli u detyrua të tërhiqej, tani ndeshje të rrepta për këto krahina do të bënte ushtria shqiptare e Lidhjes me forcat malazese, ku shqiptarët me një heroizëm korrën fitore mbi malazezët, e cila shtoi besimin te populli, se me një unitet rreth Lidhjes me luftë mund të arrihej ruajtja e tërësisë tokësore, por që ashpërsoi edhe më tepër marrëdhëniet mes Lidhjes dhe Portës. Ato u ashpërsuan rreth çështjes së Hotit dhe Grudës, ku tash Fuqitë e Mëdha në vend të Plavës dhe Gucisë propozuan që Malit të Zi ti ipet Hoti dhe Gruda. Këto veprime të Portës I binden shqiptarët se tash Perandoria Osmane po i përdor tokat shqiptare si plaçkë tregu dhe se duhej një vendosmëri më e madhe shqiptare për t'iu kundërvuar këtyre qëllimeve, duke bërë një rezistencë të ashpër për mos dorëzimin e këtyre krahinave. Fuqitë e Mëdha vendosën që Malit të Zi ti ipet një krahinë bregdetare ku do të ishte më e lehtë ndërhyrja e Fuqive të Mëdha. Portës së Lartë iu paraqit kërkesa që në vend të Plavës dhe Gucisë, Malit të Zi ti ipej një krahinë midis Shkodrës dhe detit Adriatik dhe qytetin e Ulqinit me rrethinë. Kështu që me këto kombinime antishqiptare të Fuqive të Mëdha në kurriz të popullit shqiptar po hym në një rrezik të ri që kërcënohej një krahinë e thjeshtë shqiptare,

¹¹ Shukri Rrahimi, Vilajeti i Kosovës... , f.61.

¹² George Gaërych, Gjysmëhëna dhe Shqiptarja, Bota Shqiptare, Tiranë 2007, f.93.

bëri që të shpërthej një valë e re zemërimi ku dega e lidhjes në Ulqin ftoi të gjithë krahinat shqiptare që të ndihmonin në mbrojtjen e qytetit e cila gjë edhe u realizua por pa sukses. Kryengritësit u thyen dhe Ulqini iu dorëzua Malit të Zi. Tërësia territoriale në kuadër të Lidhjes u mbrojtë edhe në jug, por pa sukses, për arsye se edhe Çameria ra nën sundimin Grekë. Pas gjithë këtyre luftrave në mbrojtje të atdheut Porta e Lartë vendosi që me forcë ta shuaj Lidhjen e Prizrenit duke dërguar gjeneralët më të njohur si Ibrahim Pasha dhe Dërvish Pasha me forca të mëdha ushtarake.¹³

Këta gjeneral gjakatar me gjak dhe me hekur ia arritën qëllimit të shpërndajnë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, por jo edhe shpirtin liridashës të kombit shqiptar, të frymëzuar nga idetë liridashëse të saj ku lufta do të vazhdojë deri në çlirimin e plotë të vendit.

¹³ Skender Rizaj, Katër Vilajetet Shqiptare gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori, Instituti i Historisë, Prishtinë 2008, f.139.

Lidhja e Prizrenit në letërsinë popullore

Një vend të rëndësishëm në lëvizjen kulturore të viteve të Lidhjes së Prizrenit zë letërsia popullore dhe artistike shqip.

Në letërsinë popullore një zhvillim shumë të begatshëm pati epika historike. Në qershor të vitit 1878, në ditët e themelimit të Lidhjes së Prizrenit, u botua në Aleksandri të Egjiptit vepra madhore e Thimi Mitkos “Bëleta shqiptare”, në të cilën qenë përfshirë mjaft këngë popullore historike të krijuara gjatë dhjetëvjeçarëve të mëparshëm nga poetët anonimë të krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Në hullinë e këtyre këngëve eci edhe veprimitaria popullore e viteve të Lidhjes së Prizrenit. Si më parë, edhe tani ajo pati për qëllim të përjetësonte në vargje ngjarjet tronditëse historike dhe të frymëzonte brezat e rinj për betejat e ardhshme. Por poezia popullore historike e kësaj periudhe dallohet nga ajo e dhjetëvjeçarëve të mëparshëm për frymën e saj më të theksuar kombëtare. Uniteti kombëtar i shqiptarëve që krijoi Lidhja e Prizrenit në fushën politike, u pasqyrua kështu edhe në krijimtarinë popullore historike.¹⁴

Sipas traditës, rapsodët popullore krijimet e tyre letrare më monumentale ua kushtuan ngjarjeve historike më të shënuara. Në qerthullin e këtyre ngjarjeve tani nuk hynë vetëm momentet dramatike madhore, siç ishin përpjekjet e armatosura me armiqtë e tyre, por edhe momentet politike kulmore. Kështu, krahas këngëve epike që iu kushtuan luftës për mbrojtjen e Lëkurësit e të Gjashtës, të Plavës e të Gucisë, të Hotit e të Grudës, të Kelmendit e të Ulqinit, të Slivovës e të Shtimjes, u thurën gjithashtu këngë historike për kuvendet e Prizrenit e të Gjirokastrës, të Gjakovës e të Frashërit, të Shkodrës e të Dibrës, madje edhe për forume të tilla ndërkombëtare, siç ishte Kongresi i Berlinit. Po ashtu, tani poetët anonimë u ngritën monumente në vargje jo vetëm kryetrimave që u shquan në fushën e luftës, si Mic Sokoli, Ali Ibra, Isuf Sokoli, Col Delia, Çel Shabani ose Sef Kosharja, por edhe ideologëve ose udhëheqësve politikë të Lidhjes së Prizrenit, siç ishin Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, Ali pashë Gucia, Haxhi Ymeri (Ymer Prizreni) etj.¹⁵

Të gjitha këngët popullore historike të këtyre viteve kanë karakter epik ose retorik. Pavarësisht se janë thurur nga rapsodë të viseve të ndryshme dhe në mënyrë të pavarur

¹⁴ Këngët historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Tiranë, 1978, f. 133

¹⁵ Po aty, f. 134

nga njëra-tjetra, ato bashkohen qoftë nga boshti tematik, qoftë nga frymëzimi atdhetar. Njëpërmjet vargjeve të tyre të pasura me figura dhe shprehje poetike, autorët anonimë himnizojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi luftën atdhetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në të njëjtën kohë ata stigmatizojnë herë me tallje, herë me sarkazëm armiqtë, kryesisht “shtatë krajlat” (gjashtë Fuqitë e Mëdha së bashku me Perandorinë Osmane), rreshtimi i të cilëve kundër Shqipërisë shkaktonte te shqiptarët jo frikë, por krenari.

Krenaria kombëtare, e lidhur ngushtë me besimin për të ardhmen, mbizotëron pothuajse në të gjitha këngët popullore historike të kësaj periudhe. Shqiptarët janë krenarë, sepse asnjëherë nuk i kanë lëshuar armët kundër sundimitarit osman:

*“Se Shqipnia e ka pas adet
Nga një pashë me mbyt për vjet!”*

thuhet në një këngë popullore të këtyre viteve. Sef Kosharja nuk e ndien veten të turpëruar, si dikur kreshnikët mesjetarë, kur mareshali osman Dervish Pasha e dënoi me varje në majën e një lisi. Përkundrazi, ai është krenar se vdes për atdhe

*“Po hije m’ka mue, o djemt’e mi
Se kam lanë shpirtin për Shqipni”.*

Në një këngë tjetër popullore, Dervish Pasha, pasi e shtyp Lidhjen e Prizrenit pyet: Ku ndodhet Sulejman Vokshi, që nuk po e kap dot? Ku u zhduk populli që shkon pas tij? Dhe rapsodi përgjigjet: Janë atje lart në bjeshkë, atje ku zbardhin retë dhe së shpejti do të takohen përsëri me të

*“N’ato bjeshkë, te retë e bardha
Q’atje nelt, ku zbardhin ret’
Kjoft kysmet do’i shihsh opet!”*

As Abdyl Frashëri nuk e ndien veten të mundur ose të turpëruar kur kalonte përmes Manastirit i lidhur me hekura dhe i shoqëruar nga xhandarët osmanë, të cilët po e çonin në burgun e Prizrenit. Përkundrazi, këndon rapsodi popullor, “emiri i Shqipërisë” (“udhëheqësi” i Shqipërisë) iu drejtua me krenari e me optimizëm një konsulli të huaj, i cili qeshi me ironi kur e pa të lidhur me pranga:

*“Ne e mbollëm këtë farë
Po të tjerë shqiptarë
Do ta korrin më të mbarë!”¹⁶*

¹⁶ Gëzim Rredhi: Epika historike kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Edhe letërsia artistike e këtyre viteve u dallua për karakterin më të theksuar kombëtar luftarak, për lidhjen e ngushtë me detyrat politike, për rolin më të fuqishëm edukativ atdhetar dhe për vëllimin më të pasur të krijimeve letrare.



Vrulli i lëvizjes atdhetare që shpërtheu gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit tërhoqi në fushën e letërsisë mjaft pena të reja, por shumica e krijimeve të tyre letrare mbetën të pabotuara. Përveç “Alfabetares” dhe “Kanonizmës” së Shoqërisë së Stambollit, të cilat ishin një përjashtim, Porta e Lartë nuk lejoi asnjë shkrim tjetër shqip që të botohej në Perandorinë Osmane. Por edhe jashtë kufijve të saj mundësitë e botimit ishin të kufizuara. Vetëm pak shkrime shqipe arritën të botoheshin në ndonjë organ periodik të jashtëm, siç ishte gazeta “I foni tis Alvanias” që dilte në Athinë, ose revista “Iris”, që shtypej në Bukuresht. Për të siguruar një përhapje më të gjerë në rradhët e bashkatdhetarëve, disa krijime letrare shqipe, siç ishte poema “Mori Shqypni” e Pashko Vasës dhe himni me titull “Marsejeza” i Thimi Mitkos, u botuan në fletë qarkulluese dhe u shpërndanë në atdhe me anën e veprimtarëve të Lidhjes së Prizrenit. Patí gjithashtu krijime letrare, të cilat u shpërndanë në dorëshkrim midis bashkatdhetarëve. Kështu ndodhi, për shembull, me poemën “Shqipëria”, të shkruar nga Naim Frashëri.¹⁷

¹⁷ Zekeria Rexha, Kangë popullore shqiptare të Kosovës I, Mustafa Bakija, Prishtinë 1951, f. 85

Lëvizja letrare shqipe u zhvillua kryesisht në gjininë e poezisë luftarake. Kjo u lidh me detyrat politike e kulturore më të ngutshme që shtroheshin para lëvizjes kombëtare në përgjithësi dhe Lidhjes së Prizrenit në veçanti. Si rrjedhim, tematika e rrahur prej saj ishte po ajo që trajtoi edhe letërsia politike e atyre viteve. Në çdo poezi spikat thirrja për bashkimin e shqiptarëve si një trup i vetëm pavarësisht nga dallimet fetare. Të gjithë autorët e tyre dënojnë armiqtë e atdheut - Perandorinë Osmane, Fuqitë e Mëdha, monarkitë ballkanike dhe institucionet klerikale. Të gjithë lëshojnë kushtrimin për të rrëmbyer armët jo vetëm për të fituar lirinë e Shqipërisë, por edhe për të mbrojtur tërësinë e saj tokësore. Në të njëjtën kohë ata ftojnë bashkatdhetarët e tyre për të shkruar gjuhën amtare, lëvrimin e së cilës e vlerësonin si një armë të fuqishme jo vetëm për përparimin e vendit, por edhe për thellimin e lëvizjes atdhetare.¹⁸

Krijimi letrar më i frymëzuar i viteve të Lidhjes së Prizrenit dhe në të njëjtën kohë një nga poezitë më përfaqësuese të mbarë Rilindjes Kombëtare është poema “Mori Shqypni” e Pashko Vasës. Me një pasuri figurash poetike, me një patos romantik atdhetar dhe me një gjuhë të rrjedhshme, autori synon të ngrejë peshë zemrat e bashkatdhetarëve në luftë për lirinë e atdheut. Ai e fillon poemën e vet duke kundërvënë mjerimin e atëhershëm të Shqipërisë me madhështinë e saj të dikurshme. Shqipëria, këndon poeti, dikur zonjë e nderuar, nënë trimash të dëgjuar, të cilët në të kaluarën i kallnin tmerrin armikut, tani ishte e shtrirë përdhe si një lis i lartë, gjithkush e shkelte me këmbë trupin e saj dhe askush nuk e thoshte një fjalë të ëmbël për të. Pse ndodhte kjo? Kjo ndodhte, theksonte autori, jo se shqiptarët e kishin humbur trimërinë dhe atdhedashurinë e dikurshme, por se ishin të përçarë nga institucionet fetare, se ishin të ndarë nga krerët në njëqind “çeta” dhe, si rrjedhim, në vend që të bashkoheshin kundër armiqve, luftonin kundër njëri-tjetrit. Pas tablosë dramatike, fillon shpërthimi epik i poetit atdhetar, i cili i fton shqiptarët të lënë mënjanë fetë, të bashkohen të gjithë si vëllezër, të lidhen të gjithë në një besë, të rrëmbejnë të gjithë armët dhe “Para se të humbasë kështu Shqipnia / Me pushkë në dorë le të vdesë trimnia”. Poema arrin pikën e vet kulmore kur autori lëshon thirrjen për të mbrojtur me çdo kusht tokën shqiptare: “Asht toka jonë, t’parët na e kanë lanë / Kush mos e preki! Të vdesim të tanë! / Të vdesim si burrat qi diqen motit”.¹⁹

¹⁸ Po aty, f. 86

¹⁹ Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Toena, Tiranë 1997, f.88

Këtë kalim nga nota heroike për të kalurën në gjëmën elegjiake për të tashmen, e përdorën edhe autorë të tjerë të këtyre viteve, si Thimi Mitkoja, Naim Frashëri dhe Nikolla Çako, pasi u jepte dorë që të ndiznin me patos atdhetar zemrat e bashkatdhetarëve në luftën për çështjen e madhe të Shqipërisë.

Të gjithë krijuesit letrarë të periudhës së Lidhjes së Prizrenit janë krenarë për të kaluarën e shqiptarëve, e cila zë fill me pellazgët parahistorikë, ata krenohen për figurat e mëdha që kanë hyrë në historinë e njerëzimit, si Aleksandri i Maqedonisë, Pirroja i Epirit, sidomos Skënderbeu (që, siç theksonte Naim Frashëri, i dha “dërmën” Perandorisë Turke) ose Marko Boçari (që, siç shprehej Nikolla Çako, fitoi kundër “skllavërisë” osmane). Nëpërmjet këtyre evokimeve ata i përgjigjeshin në të njëjtën kohë atij opinioni konservator evropian, që e paraqiste kombin shqiptar si një popull pa histori. Madje, si poetë, ata reagonin më me pasion sesa si prozatorë, duke arritur deri në atë shkallë sa lashtësinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve nuk e shprehnin me argumente historike, por me hiperbola letrare (për Naimin Shqipëria ka qenë gjallë që kur u krijua bota, për Mitkon shqiptarët kanë lindur para se të formohej hëna).²⁰

Ashtu si Pashko Vasa, edhe poetët e tjerë e përshkruajnë gjendjen e Shqipërisë së atyre viteve me ngjyrat më të errëta. Ata kanë pika takimi edhe kur trajtojnë detyrat që shtroheshin para vendit. Ç’na duhet trimëria, theksonte Naimi, në qoftë se prej saj nuk fiton gjë Shqipëria? Madje, vijonte ai, sot Shqipëria ka nevojë jo vetëm për trimërinë e bijve të saj, por edhe për diturinë e tyre e në mënyrë të veçantë për lëvrimin e gjuhës amtare. Në një thirrje të vargëzuar Thimi Mitkoja u kujtonte bashkatdhetarëve se për të shpëtuar nga sundimi i huaj dhe për ta ndritur kombin e tyre, duhej të luftonin për tri çështje: për lirinë, për vetëligjësinë (autonominë) dhe për shkrimin e gjuhës shqipe, përveç detyrës që ishte në rend të ditës - mbrojtja e trojeve shqiptare. Madje, të pushtuar nga patosi atdhetar, shpeshherë ata shkuan më larg se kërkesat që përmbante programi politik i Lidhjes së Prizrenit. Në shumicën e rasteve ata u bënë thirrje vëllezërve të tyre jo aq për “vetëligjësi”, sesa për “zbimin e Turqisë” dhe “lirinë e Shqipërisë”, si në kohën e Skënderbeut.²¹

²⁰ Po aty, f. 89

²¹ Këngët historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Tiranë, 1978, f. 68

Karakteristikë tjetër e përbashkët e poetëve të këtyre viteve ishte optimizmi për të ardhmen e atdheut. Ashtu si në shkrimet politike, edhe në krijimet letrare autorët ishin të bindur se, me djem trima si ata që luftuan në Guci dhe me udhëheqës të ndritur si Abdyl Frashëri me shokë, Shqipëria e robëruar dhe e prapambetur do ta fitonte një ditë lirinë e humbur e do të hynte shpejt në rrugën e qytetërimit. Në një poezi greqisht, një poet anomin e shprehte optimizmin e vet për luftën e mëtejshme të shqiptarëve me këto katër vargje:

*“Sa kohë jetojnë bijtë e Gjergjit të Madh
në Shqipëri,
Sa kohë që ata kanë moshën rinore
dhe shquhen për trimëri,
Sapo të vijë pranvera dhe tërfili
të mbijë përsëri,
Karejfilin? i shqiptarit do të ushtojë
prapë për liri!”²²*

Përpjekjet dhe luftërat heroike të popullit shqiptar kundër një koalicioni të tërë armiqsh pasqyrohen gjersisht dhe flakë në këngët popullore historike të periudhës së Rilindjes Kombëtare.

Këngët popullore historike të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit janë jehonë e drejtëpërdrejtë e përpjekjeve të gjithanshme dhe e luftërave të pabarabarta që bëri populli shqiptar për mbrojtjen e trojeve të veta për liri e pavarësi kombëtare. Tradita popullore, duke i trashëguar nga një brez te tjetri, ka ruajtur dhe përjetësuar në formë artistike kujtimin e atyre ngjarjeve epike, të atyre aspekteve të luftërave për liri të periudhës së Rilindjes....

*... Ja ka dhënë besën Dugagjinit,
mos me ia lshue tokat llatinin,
tokë llatinin mos me i lanë
pa e mbushë vorre an' e m'banë!*

Gjysma e dytë e e shekullit të nëntëmbëdhjetë për popullin tonë, për fatin e tij që me një rëndësi të veçantë, prandaj edhe vlimet revolucionare për çlirimin e atdheut vinë duke u bërë gjithnjë e më të organizuara sepse lëvizjet e mëparshme shtruan një shtrat të mirë në këtë fushë, pasi ato zgjuan dhe përforcuan ndërgjegjen kombëtare të masave shqiptare. Po

²² Po aty, f. 69

në këtë periudhë zhvillohet me një intensitet mjaft të madh kultura shqiptare, pasi ishte shkolluar një plejadë intelektualësh shqiptarë të cilët ishin në gjendje të shihnin më mirë zhvillimin e ngjarjeve politike në arenën ndërkombëtare. Edhe popujt e tjerë të Ballkanit po bënin lëvizje të mëdha për çlirimin e tyre nga Turqia e kjo ndikoi pozitivisht edhe në lëvizjet patriotike shqiptare. Këta faktor ndikuan në shtimin e kryengritjeve shqiptare kundër këtij armiku shekullor. Epika historike popullore shqiptare tani ka lëndë të pasur për të pasqyruar dhe ajo i përfytyron për mrekulli ngjarjet që pasojnë.

Një këngë e tillë e kohës së Lidhjes së Prizrenit është kënga për vrasjen e Mehmet Ali Pashës në Gjakovë i cili kishte ardhur t'i zbatoj vendimet e Kongresit të Berlinit:

*-kush e rreh 'i tel për mue ?
Babë Dovletit me ja çue
se n'Gjakovë më kanë rrethue,
më kanë mshelun porsi grue.*

Mirëpo, krerët e Lidhjes, siç dihet, qëllimeve të tij u bënë rezistencë, kurse Ramadan Zaskoci, djaloshi tetëmbëdhjetë vjeçar, në fund të vitit 1878, ia vrau telegrafistin, akt ky që e paralajmëroi pashain turk se nuk do t'ia dilte t'i realizojë obligimet e ngarkuara:

*Më 27 gusht, sahati tre,
në Prizren kish ra rrufe.
Me t'shtimet e kapaklisë,
Ish vra telegrafisti i Turqisë,
E kish vra një trim lumjan,
Ramadan Zaskoci i kanë thanë.²³*

Është interesant të vërehet se Abdullah Pashë Dreni nga Gjakova, i cili më parë ishte një nga luftëtarët aktiv të lëvizjes kur i hyri në shtëpi Mehmet Ali Pasha u shtërngua të luftoj kundër bashkëluftëtarve sipas kanunit të maleve për mbrojtjen e mikut .Sidoqoftë kulla e tij u rrethua nga mëse 3500 malësorë, gjë që flet për përpjestimin e madh që kishin marrë kryengritjet shqiptare kundër zgjedhës turke. Kryengritsit pasi vranë këtë pasha në shenjë revolte dhe urrejtje e vunë kokën e tij në një hu dhe dhe demonstruan nëpër rrugët e Gjakovës:

*Hanm' i Pashës del në shkallë;
-Kuku sot për pashallarë!
ç'na u kan kallë sarajet flakë!
-Hanm' i pashës seç po flet;*

²³ Universiteti Shtetëror i Tiranës, Historia e Popullit Shqiptar II, 8 Nëntori, Tiranë 1969, f. 133

*-Rihnja telin Babës Mbret,
Ali pashën ç'ta ka xhetë?
Me ni hu paska metë.²⁴*

Kjo skenë, tek e fundit, na pasqyron një psikologji të formuar me shekuj, prandaj na duket se këngëtari nuk e dënon aktin e tillë të Abdullah Pashë Drenit. Ndërkaq, në këtë këngë ndërrojnë sjenat njëra pas tjetrës, sa që secili varg paraqet nga një tablo në vete nga ai rrethim i rrëmbyeshëm, nga ajo dramë rrënqethëse për Mehmet Aliun, i cili shihte vdekjen me sy dhe kërkonte shtegdalje nga “baba mbreti”. Këngëtari ia thotë:

*Maxharr Pasha rrin mendue:
-Kush e rreh ni tel për mue,
babëdovleti me ja çue
se në Gjakovë më kanë rrethue,
më kanë mshel porsi grue.²⁵*

Mësojmë nga kjo këngë se këta kryengritës dinin pse luftonin dhe pse sakrifikonin, sepse e ndjenin veten e fyer e të shkelur nga fuqitë e pamëshirshme të kohës ndaj: *Qysh ke njuh, yzbashi mbret,/ fukaranë pse na e shet?* Dhe në këtë rrjedh:

*Col Delia synë sahati,
lumti goja, mirë vikati:
-Vetë po jes pashën p'e çarti!²⁶*

Vargjet me lartë ishin disa nga vargjet e këngës mjaftë të njohur dhe të dashur për shumë breza "Ka nji pashë me mytë për vjet'.

Këngët tjera të epikës historike popullore të çerekut të dytë të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX janë të lidhura drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me Lidhjen e Prizrenit dhe me ngjarjet që pasojnë atë. Dihet mirëfilli se lidhja pat dalë me një program të caktuar mirë përmes të cilit kërkohet autonomia dhe më vonë shkëputja e plotë nga Perandoria Osmane. Kështu motivi i epikës historike të kësaj periudhe është lufta kundër Turqisë. Dhe kjo epikë na thotë ashtu siq dimë edhe nga historia se përpjekjet çlirimtare qenë bërë të pakompromis gjithnjë e më të ashpra. Ky hov kryengritjesh shqiptare Turqisë i solli kokëçarje të mëdha dhe ajo që shtërnguar të dërgoj forca të mëdha ushtarake

²⁴ Po aty, f. 133

²⁵ Po aty, f. 134

²⁶ Po aty, f. 134

kundër shqiptarëve nën komandën e Dervish Pashës të cilit edhe populli ynë iu kundërvu ,dhe nga këto lufta të lavdishme lindi edhe kënga e cila shtoi hovin revolucionar të masave të gjera popullore:

*Qinro plak e ban gajret
s'do ta lam asqerin mret!
Hysen Zmajli i hipi kalit,
i çon fjalë Bajraktarit;
-Mblidhi burrat e shkepi malit!
Mon Avdiya po e pvet fisin;
-A m'i patë Zmajlin e Micin? -
-Fyt ëm fyt tha me Dervishin.
Priti djemt e mimleqetit
Të shtatë krajlat rrehin telin
-Koka mbledhun krejt Prizereni
ni murtat që e çoi dovleti
ra në Gjakovë te Abdulla Begi
Islam Aga në teqe të shejit
po i thrret Abdulla Begit;
-Priti djemt e mimleqetit
tu kan rras o në derë të haremit
tu kanë rrasë e tu kan afrue
krahtë me i pas me fluturue
gjallë pej kullës s'ju lam me shkue
gjallë pej kullës pashën se lamë
se lamë pashën kurrë për t'gjallë.
Abdulla Begi hyp në shkallë
pe ban pushkë e pe ban piskamë
po don zojat meç me dalë;
-Tash na hipi Muja në saraj
kti Shaq Currit po i çon fjalë
fjalë Shaqirit mi ka çue;
Azgan të madh të kan kallxue
a po vjen me dekë me mue?
Mimleqeti m'ka rrethue
për ç'at mik që s'desha me lëshue
s'un e lshova un qet mik
se po m'ja nxan djalit sytë
po i thonë baba tu ka koritë
s'kam çka baj veç me dhanë këtë shpirt.
Maxhar Pasha rrinë menue
kush e rreh ni tel për mue
Babë Dovletit me ia çue
se n'Gjakovë m'kan rrethue
m'kan mshel si me kan grue.
-Col Delia synë sahati*

*lumti goja ,mirë vikati;
 -Vet po jes pashë pe çarti.
 Man Avdinë po e thrret baj raki
 po i rrin n'besë sikur i jati
 po i rri n'besë si baba i vet
 -Qysh ke njeh yzbashi mbret
 fukaranë pse po na e shet?
 Ja ke dhanë besën Dukagjinit
 mos me ja lshue tokat llatinit
 tokë llatinit mos me i lanë
 pa e mush vorre an' e m'anë.*

Mund të themi se këngët e kësaj periudhe nisin me aksionin fort të suksesshëm të shqiptarëve me vrasjen e Mehmet Ali Pashës. Kjo vrasje pati jehonë të madhe dhe i bindi të tjerët se nuk luhet me fatin e popullit shqiptar. Sipas kënës po ajo ngjarje lajmroi qeveritë e Evropës edhe për një rezistencë të Lidhjes së Prizerenit. Kjo gjithsesi paralajmëron se ata ia kan frikën një tubimi të tillë dhe duhet të punojnë ndryshe për t'i realizuar të gjitha interesat e tyre në dëm të shqiptarëve. Ky program i aksionit të parë luftarak i realizuar me përpikëri jehoi në të gjitha kryeqendrat e Europës dhe në ato të Ballkanit.



Me interes është edhe kënga “*Duel mileti me faqe të bardhë*”, përmes së cilës²⁷ si nga ndonjë kronikë, vërejmë të radhitur gjeneralët turq të dërguar nga Stambolli, për t'i zbatuar vendimet e Kongresit të Berlinit në Veri, për t'i zbrapsur kryengritësit shqiptarë

²⁷ Shukri Rrahimi, Vilajeti i Kosovës, ETMMM të KSAK, Prishtinë 1969, f. 65

të papërmbajtur, të cilët, madje-madje, shpesh ia dolën në krye të kthejnë prapa sa e sa komandantë osmanë, që ndonjëherë u përpoqën të përdorin edhe butësinë taktike ndaj “rebelëve” shqiptarë, që gjojë më të mirë t’ia prejnë hovin kësaj revolte të shndërruar në rrebesh luftarak të rrallë, por:

I thotë Shkodra: “Nuk nigjojmë!
Të shtatë krajlat me bi urdi,
Pa krisë pushka nuk e lshojmë!”

Kjo këngë, vërtetë, përkon mirë me të dhënat historike, posaçërisht kur vë në spikamë fytyrën e urryer të Dervishës pashës, i cili qe njëri nga gjeneralët turq, që me repartet e veta ushtarake i kontribuoi më së shumti Stambollit, pasi që atë që nuk ia doli të bëjë Riza Pasha e ndonjë tjetër, e bëri ky me brutalitetin më të madh, duke u sjellë dëme të konsideruara shqiptarëve të drejtuar nga Lidhja e Prizrenit. Andaj, këngëtari ynë këtë e ka edhe më së shumti shënjestër të kritikës si njërin nga përfaqësuesit më të rrezikshëm të Turqisë, politikës së të cilës këngëtari edhe ia hoqi maskën pikërisht kur këndoi për mbrojtjen e Ulqinit:

*Të ejten mbrama në dy sahati
Haxhi Pasha hoq nizamin
o Shkodra e madhe hajde qëlloi gati
i'au zu shkijeve istikamin.*

*Istikamin tuj gatit
asqeria vjen tuj u avitë
zoti i madh i'au pat fal imamin
se ishalla jan shkue shehit.*

*O Haxhi Pasha, shkoi Haxhi Pasha
tuj dhan popullit habere
o çare s'kem pa e lshue Ulqinin
kem Stambollin muhasere.*

*Ulqinaku tash ia mbrini
se hala s'ka nisun me fol
o mos kujto se jem veç Ulqini
tash jem lidhë me Shkodrën tonë.*

Epika historike kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Figura e Sefë Koshares zë vend me rëndësi në ciklin e këngëve historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Edhe populli liridashës e ka ruajtur kujtimin për trimin e Lidhjes, veteranin e Plevnës, nizamin që kishte humbur syrin në Plevne ndërsa e kishte varur Dervish Pasha më 20 prill të vitit 1881, në vendlindjen e tij.

Kujtesa e popullit për ngjarjet e së kaluarës, vazhdimisht ka qenë e shprehur në akord me nevojat e kohës, me qëllim për të mos e harruar atë, për ta ruajtur dhe për ta rrëfyer brez pas brezi, për ta ruajtur në këngë meqë në këngë kanë hyrë, hyjnë dhe mbesin vetëm më trimat, ata që me veprat dhe heroizmin e tyre dallohen nga të tjerët dhe kurdoherë mbesin shembuj që rrezatojnë amanetin nëpër breza. Në këngët historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, një vend me rëndësi zënë edhe këngët e kënduara në disa variante për Sefë Kosharen, Mic Sokolin, Smajl Hysenin, Ali Ibrën, Sylejman Vokshin, Abdyl Frashërin e shumë të tjerë.

Figura e Mic Sokolit në këngët popullore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit paraqitet me dimensionin historik, realist në raport me kohën dhe synimet e shqiptarëve për çlirim nga Perandoria Osmane. Ai paraqitet me pamjen dhe fuqinë fizike të trimave të moçëm të Arbrit, të cilët populli i kujtonte si Trima të motit, si kreshnikët e dikurshëm. Duke bir besnik i Atdheut ai merr bekimin e nënës, e cila ka lindur një trim me fletë, të cilit po qe nevoja do t' i ndihmonte edhe në fushën e betejës. Ja si e ka përjetësuar heroizmin tradicional shqiptar këngëtari anonim popullor:

*Mic Sokoli n'dy tagana
-Udha e mbare! – m'i ka thane nana-
-Lufto, bir, ti per Shqipni
-mos i le turqit me hy
-n'kofte nevoja, vij me ty, –
Mic Sokoli një fjale po e flet
po i thote nanes: – Te mire mbeç!
-Pa u farue malsia krejt
-ktu nuk hyn as krajl, as mbret!...²⁸*

Betejat në Koshare, Slivovë e Shtime, më 20 dhe 21 prill të vitit 1881, që kishte për qëllim për t' i ruajtur territoret që i kishte shpallur të lira Lidhja Shqiptare e Prizrenit qysh

²⁸ Gani Çarri: MIC SOKOLI, Heroi legjendar i Lidhjes Kombëtare Shqiptare

në vitin 1878 ishin beteja të përgjakshme, në të cilat kanë rënë qindra shqiptarë, në mesin e tyre edhe disa krerë të Lidhjes si: Mic Sokoli, Sefë Kosharja e të tjerë. Këngëtari popullor nuk tregon numër të të rënëve, por rrëfen se në ato beteja kanë rënë shumë luftëtarë, duke veçuar në mesin e tyre, më trimat, ata që u futen dhe mbeten në këngë, për të mos u harruar kurrë.

*Në fushë të Shtimes asht mbledhë jezeri
Haj medet ka mbetë shumë njeri,
Mic Sokoli Smajl Hyseni.*

Rënia e Mic Sokolit në fushën e nderit, në altarin e Atdheut, në Fushë të Shtimes, në përpjekje për t'i rrëmbyer topat e rëndë të artillerisë si Dervish Pashait dhe për t' i luftuar pastaj turqit me armët e tyre, për shfaqë pikën kulmuese të heroizmit, heroizëm të cilin këngëtari popullor e ka përshkruar me elemente hiperbolizuese, për ta veçuar trimërinë e tij përballë topave të ushtrisë së Dervish Pashait.

*Mic Sokolin e vrau reja,
E vrau reja, e vrau moti,
E vrau Dervishi me gjyle topi.*

Duke zgjeruar rrëfimin për rënien heroike, këngëtari anonim popullor i ka thurë vargje trimërie heroit, i cili në momentet e fundit të jetës, kujton edhe heroizmin e shokëve, që kanë rënë po për atë ideal. Ata kishin mundësi të shpëtonin, të iknin, por nuk kishin pranuar ta linin bashkëluftëtarin e tyre, vetëm. Ky shembull tipik i luftëtarëve shqiptarë nëpër shekuj, manifeston besimin në fitore, rënien dhe varrimin e përbashkët, meqë kishin rënë për një qëllim, për një ideal.

*Mic Sokoli ban me dorë,
-More shokë s' po muj me folë
-se m ka ra do gjak në gojë,
-gjak në gojë e gjak në bark
-shtatë martina i kam n' shtat.
-Qonja babës një selam,
-Babë pashë Zotin nuk më kanë,
-Qaje Smajlin ma shumë se mue,
-Qaje Smajlin qaje Zeqën,
-Se s' kanë ikë e me m lanë vetëm.*

*-Se s' kanë ikë e vetë s' m' kanë lanë,
-Ma mbaroni një vorr t gjanë,
-Bashkë me shokët me na zanë.
-Vorr të gjanë e me pengjere.
-T'i shoh lulet prej pranvere
-Ti shoh lulet dremitçare,
-Ti shoh shoktë neper livadhe.²⁹*

Zemra jonë ka gjak sa gurra, mbi armikun bini burra!

Përveç këngëve popullore për Mic Sokolin, me këtë rast do t i referohemi edhe këngës së krijuar nga Gjokë Beci, poetit më i mirënjohur epik e heroik, që kishte veriu i Shqipërisë. Kjo këngë e kënduar nga këngëtarja Mrika Trumshit, u përhap anë e këndë trojeve shqiptare, si jehonë topash gjëmimtarë, për të dhënë kushtrimin kuptimplotë orëve jo sa duhet të mësuara të historisë, sepse nuk duhej harruar porosia e të parëve: “Zemra jonë ka gjak sa gurra, mbi armikun bini burra”.

Veçantia e këndimit të Mrika Trumshit qëndron në dashurinë që ajo ndjen për këngën, njëzimim me të, bashkimin me motivin të cilit i këndon. Ajo përveç se këndon me thellësinë e shpirtit, me një pasion të rrallë, edhe dirigjon me duar, me gjeste, me një emetim të shqiponjës në fluturim, pa i bërë zap emocionet, sepse me to i jep shpirtin këndimit deri në ekzaltim.

*Xhamadani i trimërisë
Kërcet topi dhe gjëmon trolli
Xhamadanin hapë Mic Sokoli
Për mes fushës kallldrem me gëzhoja
bash si fletët kur hapë shqiponja!..*

*Si dy krahë që i ka vatani
Tash po vjen topi Sulltanit
Zemra jonë ka gjak sa gurra,
mbi armikun bini burra...*

*Kaluan vitet kaloi një shekull,
Koha gërrye ka gur e hekur
Erdh ndër koha e iu vesh trollit
Xhamadani i Mic Sokolit.*

E pat veshë dhe Selam labi

²⁹ Epika historike II, Tiranë 1981

*kur për gryke topin e kapi
Prapë në botë sot ka sulltana
Që na mbajnë ne ndër nishana
Por se gjumë jo s' ka shqiptaria
Sytë me dritë na i mbushë Liria.*

*Shkëlqen djersa e s'njifet loti
në kët'ruall me palcë baroti,
Shkrin çeliku e lulëzoi molla,
Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola.*

Figura e Sefë Koshares në historinë tonë kombëtare ende ka mbetur e pastudiuar sa duhet. Për trimin e Koshares, të Plevnës e të Kosovës, populli ka thurë disa këngë, por mbi të gjitha shquhet një këngë me katër vargje, një epitaf madhështor, që në kohën tonë ka arritur me vargjet e pa harruara dhe shumë kuptimplote, jo vetëm për atë kohë.

*Sefë Kosharja i pari fisit,
Hije t' paska maja lisit,
-Hije m' ka e bijtë e mi!
-Kam dhanë jetën për Shqipni.
(Në një variant tjetër)
-Kam dhanë jetën për liri.³⁰*

Katër vargjet e kësaj kënge të kënduar gjatë kohës së sundimit turk kanë shërbyer si mesazh çlirimtar. Janë këto vargje që i kanë mbijetuar vitet dhe kanë bërë që figura e Sefë Koshares të mbetet e pavdekshme, në kujtesën e popullit.

Edhe pse i trajtuar si luftëtar popullor, bazuar vetëm në disa fragmente këngësh, ai ka qenë para së gjithash një ushtarak i dalluar i kohës. Fakti se ai kishte kryer nizam, rekrutimin e detyruar në ushtrinë e Perandorisë Osmane, pastaj kishte luftuar dhe ishte dalluar në frontin e Plevnës së Bullgarisë në vitin 1877 dhe kishte qenë topçi në radhët e artilerisë së Osman Pashës, jep për të kuptuar se ai ishte një personalitet që njëhej jo vetëm në Kosovë.

Në një këngë tjetër vargjet e njohura për Sefë Kosharen janë ndërruar por pa e prekur porosinë

*Sefë Kosharja i pari fisit
"Po mbledh lena në maje të lisit"
Në maje të lisit haj medet*

³⁰ Epika historike II, Tiranë 1981, f. 306

*Për liri ka ndërrue jetë.*³¹

Vargu “po mbledh lena në maje t’lisit”, mbase është interpretuar në mënyrë figurative, por pavarësisht nga kjo hetohet një përpjekje për shpërfillje, sepse, në një kohë kishte qenë luftëtar i Sulltanit. Më vonë kishte kaluar në radhët e krerëve të Lidhjes. Një këngë tjetër e shënuar në fshatin Vojnoc, afër Koshares në vitin 1953, po kështu ka të bëjë me varjen e Sefë Koshares, më 20 prill të vitit 1881.

*Dervish Pasha në shallvare
I qet topat në Koshare,
-Ose Sefën këtu e due!
-Ja Kosharen kam me shkrumue,
-Ose Sefen e due të gjallë,
-Ja Kosharen kam me kallë,
-Kam me djegë me rob e fëmijë
-Nuk po doni Osmanli.
Sefë Kosharja lulja e fisit,
Po luhatet në degë të lisit.*³²

Në këngët epike-heroike për Mic Sokolin, Sefë Kosharen, Smajl Hysenin, Hysen Smajlin katër krerë dhe luftëtarë të dalluar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, këngëtari popullor shpreh dhembje për humbjen e trimave, por në vargje tipike popullore i këndon heroizmit të tyre dhe jo dorëzimit e pendimit. Ata kishin rënë trimërisht dhe populli i kishte thurë edhe vargje të dhembshme, meqë kishin qenë trima të zgjedhur dhe kishin rënë në luftë për ta bërë Shqipërisë e Katër Vilajeteve, të cilin nuk po e bëjmë dot as tani pas 133 viteve.

³¹ Këngë popullore historike II, Prishtinë 2007. faqe 135

³² Këngë popullore historike II, Prishtinë 2007. faqe 136



“S’na ka le lokja prej barkut, na ka qit pushka prej qarkut”

Vepra dhe heroizmi i Sefë Koshares ka qenë burim frymëzimi për këngëtarët qysh nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në ditët tona. Heroizmit të tij i kanë kënduar sa e sa këngëtarë, madje edhe këngëtari i mirënjohur, Arfi Vladi. Kjo këngë e thurur dhe e kënduar me mjeshtri artistike, ka sintetizuar variantet e këngëve anonime popullore, për trimin Sefë Kosharja dhe bashkëlufëtaret e tij. E kënduar me një përkushtim të rrallë, me një ritmikë epike heroike, kënga pasqyron luftën dhe qëndresën shqiptare nëpër shekuj, luftën për jetë a vdekje, amalgamin shqiptar të mbijetesës, tejheroizmin me vargjet:

*S’na ka le lokja prej barkut,
Na ka qitë pushka prej qarkut...
Se s’kam vdekë, e s’kam me vdekë!...*

Këto vargje të thurura me mjeshtri artistike, pasqyrojnë më së mirë qëndresën shekullore, historike, tipike shqiptare, atë qëndresë e cila iu vesh truallit si xhamadan i trimërisë, në kohën e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën shembujt e heroizmit tipik shqiptar, nga Legjendari Adem Jashari dhe nga bashkëlufëtaret e tij.

*Sefë Kosharja i pari fisit,
Hije te paska maja lisit,
Hije m’ka o shoktë e mi,
Kam dhanë jetën për liri,
Kam dhanë jetën për liri,
Jam shqiptar kosovarli.
S’na ka le lokja prej barkut,
Na ka qitë pushka prej qarkut.
Amanet për mem varrue,
Varrin me ma hijeshue,
Ti shoh fushat jeshilue,*

*T' shoh flamurin tuj flakërue,
Due mauzerin për bri varrit
Ja ngjit hasmit në lule të ballit
Due mauzerrin me gjithë fishekë,
Se s'kam vdekë, e s kam me vdekë!
Mal me gjak asht ba Kosova,
Luftë po ban, Sefë Kosharja,
Po ban luftë, po ban kerdi,
Gjëmojmë malet, duan liri,
Nuk jeton shqipja pa diell,
Nuk duron shqipja robni
Jam shqiptar kosovarli.*

Sefë Kosharja zë vend me rëndësi në ciklin e këngëve historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Edhe populli liridashës e ka ruajtur kujtimin për trimin e Lidhjes, të cilin e kishte varur Dervish Pasha, më 20 prill të vitit 1881, në vendlindjen e tij.

Përfundimi

Në përfundim të këtij punimi të shkurtër ku bëhet fjalë për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit njëherën prej ngjarjeve më të rëndësishme politike të kombit shqiptar jo vetëm kur ajo u themelua dhe ka vepruar por në përgjithësi të tërë historisë sonë kombëtare mund të japim konkluzion se Lidhja e Prizrenit ishte një organizatë e parë me karakter kombëtar e formës së organizimit të mirëfilltë, jo vetëm të gjitha klasave shqiptare të kohës, por edhe të krahinave të saja të cilat u bashkuan rreth Lidhjes për mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut të rrezikuara nga politikat imperialiste dhe antishqiptare të dala nga traktati famëkeq i Shën Stefanit, e po ashtu, edhe të Kongresit të Berlinit. Gjatë shtjellimit të këtij punimi mbi rrethanat që ndikuan për formimin e Lidhjes së Prizrenit dhe veprimtarin e saj në dobi të kombit shohim situatën tejet të rëndë të kombit shqiptar si nga sundimi i Perandorisë Osmane e cila tash në këtë kohë po dobësohej dita në ditë dhe do të quhet prej disa fuqive si e “Sëmura e Bosforit”.

Dhe nuk ishte më në gjendje të kontrollonte territoret e veta nën sundimin e të cilave ishin edhe shqiptarët të ndarë në katër Vilajete administrative dhe po lëshonte pe me copëtimin e tokave shqiptare sidomos pas disfatës së Luftes Ruso-Osmane 1877-1878, kur ajo pësoi disfatë të rëndë dhe u detyrua të nënshkruaj traktatin e Shën Stefanit, në të cilën dominoi politika Pansllaviste Ruse me favorizimin e shteteve sllave të Ballkanit duke iu dhënë shumë territore të tokave shqiptare.

Pra siç po shihet shqiptarët në prag të Lidhjes së Prizrenit kur Kriza Lindore ishte në kulmin e vet shqiptarët u gjenden në një situatë tejet të rëndë midis kordhës dhe çekanit të pambrojtur nga sundimi osman dhe të rrezikuar nga pansllavizmi Rusë me aleatët e vet Ballkanik. Siç shihet para formimit të Lidhjes së Prizrenit kombi shqiptar ishte i rrezikuar si në planin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm.

Në Kuvendin e mbajtur në Prizren me rastin e formimit të Lidhjes Shqiptare krerët më largëpamës të Lëvizjes Kombëtare shpresonin se do të arrinin ndonjë qëllim për të bindur fuqitë e mëdha të kohës të cilat do të tubohen në Kongresin e Berlinit se do të mirren seriozisht edhe me çështjen shqiptare, por siç do të tregojnë ngjarjet gjatë mbajtjes së këtij Kongresi Fuqitë e Mëdha fare nuk u interesuan për kombin shqiptar bile vendosën

që shumë territore etnike shqiptare t'iu open shteteve fqinjë të Ballkanit si Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, duke bërë një padrejtësi të rëndë ndaj tërë kombit shqiptar.

Në një situatë të tillë të rëndë që u gjend Shqipëria dhe shqiptarët nuk mbeti gjë tjetër veç që nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit t'i përmbledh forcat që me luftë të armatosur të mbrohet tërësia territoriale e atdheut gjë edhe çka ndodhi ku një pjesë të kësaj lufte për ruajtjen e tërësisë territoriale të atdheut e kemi paraqit në fund të këtij seminari ku bëhet fjalë për veprimtarin ushtarak të Lidhjes për të mbrojtur atdheun nga copëtimi.

Lidhja shqiptare e Prizrenit pati aktivitet të shkurtër vetëm tre vjeçar, por mjaft të frytshëm në organizim, në veprimtari, në mbrojtjen e interesave jetike kombëtare shqiptare përball vështirësive të shumta si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Literatura

1. Belegu, Xhafer. Lidhja e Prizrenit, Tiranë 1939.
2. Buda, Aleks. Shkrime Historike 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë1986.
3. Buxhovi, Jusuf. Kongresi i Berlinit 1878, Faik Konica, Prishtinë 2008.
4. Çabej, E. *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Botime Çabej, MÇM, Tiranë, 1994
5. Frashëri, Kristo. Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Toena, Tiranë 1997.
6. Historia e Popullit Shqiptar II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2002.
7. Muzaka, Thoma. Politika Ballkanike e Ruisë dhe çështja shqiptare, Mësonjëtorja e Parë, Tiranë1999.
8. Epika historike II, Tiranë 1981
9. Këngë popullore historike II, Prishtinë 2007
10. Rizaj, Skender. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente Angleze, Arkivi i Kosovës, Prishtinë
11. Rizaj, Skender. Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885, Drita, Prizren 1998.1978.
12. Rrahimi, Shukri. Vilajeti i Kosovës, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Prishtinë 1969.
13. Qosja R. *Historia e Letërsisë Shqipe Romantizmi I Rilindja*, Prishtinë, 1990
14. Qosja R. *Historia e Letërsisë Shqipe Romantizmi II Rilindja*, Prishtinë, 1990
15. Qosja R. *Historia e Letërsisë Shqipe Romantizmi III Rilindja*, Prishtinë, 1990